



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 4701 prot.

Berat , më 22.09. 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues " Mbi miratimin e kërkesës së Bashkisë Berat, së bashku me dokumentacionintekniko- ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Andrea Lamkollari banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri, nga buxheti i bashkise dhe buxheti i vitit 2021 në ministrinë e mbrojtjes, programi " emergjencat civile "

KRYETARI
Ervin DEMO



Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi,: Drejtor i Emergjencave Civile ,Pronave ,Transportit dhe Sherbimeve

Konceptoi:

Hajrie Mbrati Specialist i Emergjencave Civile

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHERBIMEVE

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET BANESAT E TË CILËVE JANE DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISE I VITIT 2021, PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE “

Te nderuar keshilltare,

Ne daten 28.07.2021 nga zjarri u demtua 1 banes ne Bashkine Berat .

Pas arkivimit te kërkeses së shtetasit Z. Andrea Lamkollari, date 02.08.2021, banor Lagjen 3 Uznove, Bashkia Berat, komisioni i ngritur me Urdherin Nr.425 date 02.08..2021 te Kryetarit të Bashkise “ Për ngritjen e komisionit për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në datën 28.07.2021 në banesën me pronar z. Andrea Lamkollari ndodhur ne Lagjen 3 Uznove , Bashkia Berat , shkoi ne vendngjarje dhe në bazë te konstatimit fizik, hartoi proces verbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret për procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “

Proces verbali i konstatimit u përcollë në Këshillin e Qarkut me shkresat Nr. 4053 Prot, datë 04.08.2021 për vlerësimin e dëmeve sipas ligjit.

Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut,ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e z. Andrea Lamkollari, janë përcjellë në Bashkinë Berat me Nr 4053/1 Prot , datë 01.09..2021. Në mbështetje të preventivave të hartuara nga grupi i ekspertëve dërguar në Bashkinë Berat rezultojnë demet :

a. Punime ndërtimore	549 150 leke
b. Orendi dhe pajisje	132 500 leke
Totali	681 650 leke

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë, në VKM Nr.329 datë 16.05.2012 shkronjën “ ç”, të pikës 1, të kreut III; i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë vlerën e ndihmës së menjehëreshme financiare për:

Z. Andrea Lamkollari ne vlerën **340 825 leke**

Ndihma financiare do të përballohet nga fondet e emergjencës së Bashkisë për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkoheshme të jetesës , si dhe për shpenzime të tjera për përballimin situatës emergjente .

DREJTORI FINANCES

Rovena SHEHU

DREJTORI DECTP

Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

“ MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONINTEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z ANDREA LAMKOLLARI BANESA E TË CILIT ESHTË DËMTUAR NGA ZJARRI , NGA BUXHETI I BASHKISE DHE BUXHETI I VITIT 2021 NË MINISTRINË E MBROJTJES , PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE “


Mbështetur në Ligjin Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , Ligjin nr. 8756, date 26.03.2001 “ Per Emergjencat Civile “ i ndryshuar dhe VKM nr. 329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore “: me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Te miratojë kërkesën e Bashkisë Berat për mbështetje financiare të shtetasit Andrea Lamkollari per demtimin e baneses nga zjarri i rënë në datat 28.07.2021
2. Te miratoje dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Berat.
3. T'i akordojë si ndihmë emergjente nga buxheti i Bashkise Berat, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkisë për vitin 2021, familjes së shtetasit
 - Andrea Lankollari ne vleren **340 825** (treqindeedyzetemijeeteteqindeenjezeteepese)
4. Ndhma financiare për familjen e shtetasit Andrea Lankollari përcaktohet sipas kriterëve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
5. Ndhma financiare që do te akordohet do të perdoret per t'i ardhur në ndihmë familjeve të shtetasit Andrea Lankollari banesa e të cilit eshte dëmtuar nga rënia e zjarrit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës , Drejtoria Emergjencave Civile Pronave Transportit dhe Sherbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 4703 prot.

Berat, më 02.09.2021

Lënda : Dërgohet material për informim

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar Zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë materialin informues “ Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë së Beratit , i përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar, Faza e Rishikuar “.

KRYETARI

Ervin Demo

Konfirmoi :

Drejtoria Juridike : Petro Sinjari

Konceptoi :

Rovena Shehu , Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

Datë:

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit : 1

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues : ____





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE TË ARDHURAVE

Berat, më ____/____/2021

RELACION

MBI DOKUMENTIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024 TË BASHKISË SË BERATIT , I PËRGATITUR SIPAS INSTRUMENTIT TË PLANIFIKIMIT FINANCIAR, FAZA E RISHIKUAR

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të Kalendarit Buxhetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr 23 date 30.07.2018, ‘Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA vendor 2022-2024”, si edhe Udhëzimit Plotësues nr 20 datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA vendor 2022-2024”,

ju paraqesim dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024 , i përgatitur sipas instrumentit të planifikimit financiar, faza e rishikuar.


Dokumenti është përgatitur nga grupi GMS dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore, në përputhje me udhëzimet përkatëse.


Ky dokument është dërguar në Ministrinë e Financave brenda datës 15 Shtator.

E sjellim tek ju për informim dhe si material bazë për të organizuar nga juaj dëgjesat me publikun, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Ju faleminderit!

Grupi i punës :

Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave : Rovena Shehu 

Drejtor i Taksave dhe Tarifave : Sokol Toska 

Drejtor i Planifikimit Urban : Luciano Bojaxhiu

Drejtor i Emergjencave, Pronave dhe Transporti : Erlin Kuçi

Drejtor i Shërbimit Social : Pirro Xheblati

Drejtor i Burimeve Njërëzore : Gentian Dashi

Drejtor Juridik : Petro Sinjari

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit Bashkia Berat : Klodiana Hoxha

Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë : Bledar Çili

Drejtor i Shërbimeve Publike : Polizoi Ikonomi

Drejtor i Ndërmarrjes së Gjelbërimit : Xhoxhi Gjoka

Drejtor i Qendrës Lira : Alma Kule

Drejtor i Qendrës Kulturore "M. Tutulani" : Arben Qafa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 4709 prot.

Berat , më 22.09 2021

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.


Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, mbi miratimin e projektit:“ P06_ Restaurimi i peizazhit historik urban të sheshit të Selamllëkut –Berat” dhe miratimitin e vendimit mbi shpronësimet per realizimin e projektit P06.

KRYETARI
Ervin Demo



Konfirmoi:

Petro Sinjari: Jurist, Drejtoria Juridike

Konceptoi:

Lucjano Bojaxhiu: Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit te Investimeve

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT: “P06_ RESTAURIMI I PEIZAZHIT HISTORIK URBAN TË SHESHIT TË SELAMLLËKUT –BERAT”

“MIRATIM VENDIMI MBI SHPRONESIMET PER REALIZIMIN E PROJEKTIT P06“

I. QËLLIMI I PROJEKTIT

Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik (PZHIUT), i financuar nga Grupi i Bankës Botërore dhe i vënë në zbatim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), mbështet Qeverinë e Shqipërisë për të zhvilluar ekonominë dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës në rajonin jugor duke financuar projekte infrastrukturore në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit dhe Përmetit.

Qëllimi i kësaj detyre është të kontribuojë në zbatimin e komponentit 1 të PZHIUT në dy qytete, Berat dhe Përmet, duke zhvilluar Koncepte të Integruara Projekti Urban (KIPU), me fokus në zonat në studim të qyteteve, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve vendas dhe rritjen ekonomike bazuar në zhvillimin e turizmit lokal në zonat urbane.

Pas vlerësimit të Konceptit të Integruar të Projektit Urban për Beratin (faza B) dhe të Programit të Investimeve të zonës së projektit (faza C), një nder nënprojekt-investimet e përzgjedhura për zbatim në Berat është dhe:

– **P06 Restaurimi i peisazhit historik urban të sheshit të Selamllëkut**

Projekt cili trajton përmirësimin e zonës, lëvizjen këmbësore dhe hapësirat publike përgjatë rrugicave duke propozuar një hapësirë të shtuar urbane dhe një hapësirë të gjelbëruar.

2. Konteksti i Projektit

2.1 Konteksti urban

Zona e projektit është nyja lidhëse e qytetit historik dhe modern. Ajo përfshin sheshin rreth si Selamllëkut të familjes së Vrionasve deri tek “Porta e Pashait”. Projekti përfshin gjithashtu dhe një hapësirë të lirë në nyjen e rrugës "Mihal Komneno dhe Antipatreja.

Ish “Selamllëku i Vrionasve” dhe Porta e Pashait janë monumente të të Kategorisë së I, pjesë e kompleksit ndërtimor të Pashallëkut të Vrionasve, që gjëndet midis lagjes së vjetër historike të Mangalemit dhe qytetit modern.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA BERAT

Projekti ndodhet në qendrën historike të UNESCO-s, duke korresponduar me Planin e Menaxhimit të UNESCO-s 2008 "Zona 1", "Kjo zonë mban atë çfarë ka ngelur në këtë qytet nga Periudha Otomane. Ajo është në gjendje të degraduar dhe ka nevojë për sistemim urban dhe arkitektonik".





Figure 1. Konteksti urban

2.2. Zona e projektit


Projekti *P06 Restaurimi i peizazhit historik urban të sheshit të Selamllëkut* përfshin hapësirën publike dhe një pjesë të vogël të hapsirave private në këtë zonë. Në restaurimin e kësaj zone përfshihen katër objekte. Ndërhyrja do të përqëndrohet në: sheshin e Selamllëkut, Porta e Pashait, zona pranë shkollës "Llambi Goxhomani" si dhe një hapësirë e lirë në nyjen e rrugës "Mihal Komneno dhe Antipatrea. Më poshtë dotë shikoni dhe shtrirjen e këtij projekti në hartë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Figure 2. Zona e ndërhyrjes. Hartë nga Vexhi Buharaja – Berati në FototekaParashqevi Sahatci



2.3. Plani i Përgjithshëm Vendor

PPV-ja e Beratit është përgatitur në 2016. Vizioni i propozuar për zhvillimit e Beratit synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë. **Nënprojekti i P06** duke iu referuar Përdorimit të tokës në PPV bie në pjesën 1/18 "Monumente të trashëgimisë kulturore dhe historike" dhe 1/80 "Institucione". Duke iu referuar dhe planit të qarkullimit, nënprojekti përfshin rrugën "Antipatrea" dhe "Mihal Komneno", rrugë kryesore kjo që të con në Kala. Rrugicat historike të Mangalemit nuk janë pjesë e rrjetit të rrugëve kryesore të PPV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT



3.1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT

Kjo ndërhyrje ka për qëllim rigjenerimin e hapësirës publike në pjesën fundore të Mangalemit. Zona ka qenë pjesë e kompleksit të familjes së Vrionasve, e prishur së bashku me pazarin e Beratit gjatë periudhës së realizmit socialist. Selamllëku ka mbetur si një strukturë e braktisur. Ky projekt i përgjigjet objektivit të zhvillimit të PZHIUT: nxitja e zhvillimit ekonomik bazuar në turizmin lokal në zonat urbane. Brenda kuadrit të KIPUt, zbatimi i këtij projekti do të ofrojë një mundësi të jashtëzakonshme për të zhvilluar një hapësirë urbane të rigjeneruar, duke u bërë kështu një projekt kyç, duke funksionur si një hyrje për në qytetin e vjetër, njëje ndërmjet Mangalemit, zonës Kodrinore në Lindje dhe Qendrës së Qytetit.

REZULTATET E PRITSHME

– Ruajtje e vlerave urbane dhe arkitektonike të dy monumenteve të Kategorisë I.

– Rreth 4,595 m² hapësirë urbane e rehabilituar.

MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA

Projekti do të menaxhohet dhe mirëmbahet nga Bashkia e Beratit, pasi hapësirat e lira janë nën kujdesin e bashkisë.


Ky projekt ka dy komponentë:

– restaurimi i Portës së Pashait;

– rehabilitimi i hapësirës së lirë rrotull ish Selamllëkut të Vrionasve, duke përfshirë hapësirën që fitohet nga prishja e shkollës 9-vjeçare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT



Pamje
Grumbullim
Fasllme të përkohshme
Monument visit

Platforma
Hapësirë pushimi
Lidhje hapësirash

Hapësirë e gjelbëruar
Hapësirë qendrimi
Përmirësim peizazhi

Hapësirë pushimi
Lidhje hapësirash

Pazat i përkotshëm
Lidhje hapësirash




Fig.Koncept projekti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT




Fig.Vizualizime te projektit

Ky projekt do të përmirësojë aksesin për këmbësorët në të gjithë mjedisin urban, duke e përmirësuar lëvizshmërinë në rrugicat historike. Të gjitha rrugët që janë në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

pritje për ndërhyrje janë rrugë shumë të përdorura nga këmbësorët. Kjo ndërhyrje do të përmirësojë dukshmërinë dhe aksesin për të gjithë duke mundësuar një sistem ndricimi dhe mobilimi urban. Gjithashtu rëndësi i kushtohet edhe përmirësimit të aksesit tek Ura e Varur për personat me aftësi të kufizuar nëpërmjet realizimit të një rampë-shkalle, në të dy anët e saj.

3.2. Përshkrim i objekteve specifike

Objekti 1 (Selamllëku i Vrionasve) ka qenë konceptuar si një rezidencë për miqtë. Struktura dallon për cilësinë e lartë të punimit të gurit dhe pamjen e hijshme arkitektonike. Kati përdhe është ndërtuar me muraturë guri. Në anën jugore, veriore dhe lindore harkadat kanë pas mbajtur katin e sipërm me konstrukcion druri, i cili nuk ekziston më. Një pjesë e ndërtesës është origjinale, ndërsa më vonë është shtuar një bllok në një nivel tjetër. Së fundi, është shtuar edhe një tarracë me kolona betoni të papërfunduara dhe struktura është përforcuar me beton. Sot ndërtesa nuk ka funksion.

Ish Selamllëku i Vrionasve sot paraqet një rrënojë historike, pa funksion dhe me nivel të lartë degradimi. Shumë ndërhyrje janë bërë në strukturën ekzistuese, të cilës sot i mungon volumi i katit të dytë. Gjatë viteve janë bërë disa ndërhyrje duke shtuar disa kolona betoni në një tentativë për rindërtim. Dokumentimi historik dhe projekti i restaurimit i siguar nga DRKK, tregon se pjesa përfundimtare e ndërtesës është rindërtuar në 1996 pa ndonjë teknike dalluese për të vërtetuar shtresat kohore. Sot ajo paraqet një strukturë hibride me një nivel të lartë degradimi.



Fig. Gjendja ekzistuese e ish Selamllëkut të Vrionasve

Objekti 2 (Porta e Pashait) është e vetmja ndër tre portat e kompleksit që vjen në ditët tona. Daton në shek. XVIII dhe ka shërbyer si hyrje e vjetër për në kompleks. Porta është e ndërtuar me gurë dhe ka një hark të madh elegant dhe motive floreale të gdhendura. Pjesa e sipërme e strukturës ka qenë një tarracë en shfrytëzueshme. Sot, struktura ka nevojë për restaurim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT





Fig. Porta e Pashait, gjendja ekzistuese dhe foto të vjetra

Zona 3 është zona e parashikuar për studim arkeologjik. Nën masivin e dheut mund të gjenden mbetje të ish kompleksit së familjes së Vrionasve.



Fig. Rrenojat

Zona 4 përbëhet nga një shkollë 9-vjeçare dhe oborri i saj. Shkolla, e cila është përdorur shumë pak gjatë viteve, duhet të prishet detyrimisht dhe klasat e saj të vendosen në një shkollë në afërsi, duke bërë në këtë mënyrë një menaxhim më efikas të shërbimit të arsimit të ofruar. Prishja e shkollës është konsideruar themelore për përmirësimin e përvojës së turistëve në Berat, vecanërisht kur qëllimi është përmirësimi i peisazhit të Mangalemit dhe Kalasë. Bashkia ka rënë dakord me rialokimin e këtij asemi dhe Klienti është duke marrë në konsideratë masat e nevojshme të dakordësisë me Drejtorinë e Arsimit si dhe zhvendosjen e nxënësve.



4.1 PËRSHKRIMI I PROÇESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE

4.1.1 Përshkrimi i përgjithshëm i projektit

Kjo zonë, duke qenë një nyje e strukturës urbane në pjesën lindore të kodrës së Kalasë, mund të aksesohet lehtësisht nga Mangalemi, Qendra Mesjetare, zona BID dhe Ura e Varur që shkon në Goricë. Kjo ndërhyrje do të përmirësojë pamjen dhe aksesin për të gjithë Mangalemin dhe qendrën historike dhe do të ofrojë një mundësi për interpretimin e historisë së qytetit dhe për informimin e turistëve përpara se të vizitojnë lagjet historike.

Ndërtesat dhe hapësirat e lira do të jenë të aksesueshme për karrocet e fëmijëve dhe personat me aftësi të kufizuara. Do të vendoset një sistem i veçantë ndriçimi dhe sinjalistike për orientim dhe për të garantuar sigurinë.

4.1.2 Ndërhyrjet inxhinierike, shtrimet natyrale apo të ndërtuara

Punimet do të përfshijnë:

- prishjen e shkolles 9-vjecare
- restaurimi i Portës së PashaIt
- heqje e kangjellave ekzistuese
- shtrim dhe gjelbërim i hapësirave të lira
- parashikim i parapeteve të rinj
- mobilim dhe ndriçim special
- parashikimi i kapakëve të pusetave me pllaka mbyllëse që t'i përshtatet rrugicave;
- rikonstrukcion i shtrimit ekzistues me kalldrëm duke ripërdorur materialet dhe teksturen origjinale me zëvendësim në lloj në rastet kur mungon guri sipas nivelit të degradimit;
- heqje e ndërhyrjeve të papërshtatshëm
- trajtimi i sipërfaqeve me biokside për heqjen e bimesisë invazive;
- përforcim strukturor i mureve dhe elementeve të tjerë
- ndriçim i hapësirave

4.1.3 Mobilimi urban

Mobilimi urban do të përfshijë si më poshtë:

- ndriçim;
- kosha mbeturinash.
- Tezga të përkohshme
- Karrige të përkohshme
- Vazo gjelbërimi të lëvishme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

4.1.4. Rrjetet dhe shërbimet

Instalimet MEH do të përfshijnë si më poshtë. Ndricimi dhe rrjeti elektrik. Në zonën në studim, do të ketë një ndërhyrje të përgjithshme në ndriçimin publik duke zëvendësuar ndriçuesit ekzistues me një sistem ndriçimi të ri LED. Të gjitha pajisjet do të jenë efikase në përdorimin e energjisë. Ndricimi nuk do të jetë invaziv, duke synuar limitimin e humbjeve të energjisë dhe ndotjes nga ndricimi i tepërt. Kabllot elektrikë do të vendosen nëntokë. Gjatë zbatimit të projektit këto ndërhyrje do të jenë në kordinim me OSHEE-në si pronar dhe administrator i këtyre strukturave.

Drenazhimi. Zona do të pajiset me një sistem të përshtatshëm për drenazhimin e ujrave të shiut me puseta të vendosura në intervale të paracktuara. Sistemi nëntokësorë i këtyre pusetave do të orientojë ujrën në sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit. Menaxhimi i mbetjeve. Koshat e meturinave do të pozicionohen nëpër rrugica për mbledhjen e mbetjeve të vogla. Kazanet e mbeturinave ekzistues do të qëndrojnë aty ku janë.




Fig. Mobilimi Urban; ndricimi dhe shtresat e propozuara për zonën e nënprojektit P.06



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

4.1. 5 Restarurimi i shtrimit të rrugëve.

Restarurimi i shtrimit të rrugëve do të bazohet në nivelin e degradimeve (shiko tabelën 4). Aty ku parashikohet vendosja nëntokë e tubacioneve për infrastrukturën nëntokësore, do të hiqet shtrimi ekzistues i rrugëve dhe do të rindërtohet. Në të dyja rastet shtrimi do të restaurohet si në gjendjen origjinale, me të njëjtat materiale, motive shtrimi dhe teknika ndërtimore. Në puseta opsioni më i mirë për mbylljen e tyre është krijimi i kapakëve me shtrim mbi strukturën e tyre metalike. Shtrimi mbi kapakë duhet zgjedhur me kujdes që të përkojë me shtrimin përreth pusetës, që të sigurojë vazhdimësi në material dhe motiv të shtrimit të rrugicës.

NIVELI	ID	DEGRADIMI	NDËRHYRJET
NIVEL I ULËT	P1	Rritje e pakontrolluar e bimëve dhe myshkut	Heqje dhe trajtim i sipërfaqeve me biokside të përshtatshme
	P2	Humbje e gurëve të shtrimit	Zëvendësimi i gurëve të munguar ose të degraduar
	P3	Shtrim i rrënuar	Meremetim ose rindërtim i shtrimit me kalldrëm tradicional në zonat ku mungon pjesërisht ose shkon përtej riparimit
NIVEL MESATAR	P4	Puseta të gabuara ose të papërshtatshme	Kapakët e pusetave duhet të jenë me gurë për t'u përshtatur me sipërfaqet e shtruara
	P5	Terreni i paqëndrueshëm dhe / ose zhvendosja e substratit	Stabilizim dhe përforcim i nënshtresave
NIVEL I LARTË	P6	Degradim strukturor i urës / shkallëve	Përforcim strukturor

Tabela. Degradimi i shtrimit të rrugëve dhe ndërhyrjet koresponduese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Tabela. Elementët që do shtohen në këtë nën-projekt

Elementi	Sasia (cope)
Kosha	4
Karrige	10
Pemë lartësi deri 6-12 m	12
Ullinj me lartësi 6-9 m	3
Shkurre dekorative	8
Ndricues shtyllë	21
Ndricues te varur	60
Projektor për pemet	24
Ndricues rrenojash	25
Ndricues murale	28
Tezga	14

Zona në të cilën do të zhvillohet projekti ofron gjithë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e këtij projekti. Në zonën në të cilën do të zhvillohet projekti janë të shtrira tashmë sistemi i Ujesjellesit, rrjeti i Kanalizimeve, rrjeti elektrik, ai i telefonisë fikse, sikurse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

5.1. DETAJE TE PLANIT TE ZBATIMIT


5.1.1. Restaurimi i peisazhit historik urban të sheshit të Selamllëkut

Miratimet e nevojshme:

- Keshilli kombëtar i restaurimeve.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
- Këshilli Kombëtar i Territorit

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet shtrirja kohore e projektit duke nisur nga fillimi i projekt zbatimit. Nuk përfshihet periudha e garancisë prej 12 muajsh.

Tabela. Grafiku i Projektit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KESHILLI BASHKIAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

**MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT:
“P06_ RESTAURIMI I PEIZAZHIT HISTORIK URBAN TË SHESHIT TË
SELAMLLËKUT –BERAT”
“MIRATIM VENDIMI MBI SHPRONESIMET PER REALIZIMIN E
PROJEKTIT P06“**

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve në mbështetje të nenit 7 pika 2, neni 8, 9 dhe 54, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, të ndryshuar :

V E N D O S I :

- 1.Te miratohet si proritet investimi me objekt : “ P06_ Restaurimi i peizazhit historik urban të sheshit të Selamllëkut –Berat”
2. Te miratoje fillimin e procedurave mbi shpronesimet per realizimin e projektit P06-Restaurimi i peizazhit historik urban të sheshit të Selamllëkut –Berat”.
- 3.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

K R Y E T A R

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 4705 prot.

Berat , më 22.09. 2021


Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin “Për fillimin e procedurave të shpronësimit me qëllim zgjerimin e varrezave publike në Fshatin Moravë”.

KRYETARI
Ervin DEMO



Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi, Drejtorja e Emergjencave Civile Pronave Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi:

Denada Gjogu, Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT ME QËLLIM ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE NË FSHATIN MORAVË

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat ka filluar shpronësimin për interes publik për pasurinë nr. 1189/25 e llojit “tokë arë”, në ZK 2723, me qëllim zgjerimin e varrezave publike të fshatit Moravë, Njësia Administrative Otlak.

Bashkia Berat ka bërë përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e hapësirave të lira të tokës, për krijimin e kushteve të përshtatshme për tu përduror, për banorët e kësaj zone që ndërrojnë jetë. Realizimi i këtij investimi është një domosdoshmëri, për shkak të mungesës së sipërfaqjeve të lira në varrezat ekzistuese, duke shkaktuar problem me menaxhimin e rasteve kur banorë të kësaj zone ndërrojnë jetë.

Kur numri i vdekjeve është rritur në mënyrë të ndjeshme edhe për shkak të pandemisë, kërkesa për zgjerimin e varrezave është sa e nevojshme dhe që kërkon reagim të menjëhershëm, si një rast emergjence pasi janë ezauruar të gjitha mundësitë për shfrytëzimin maksimal të vendeve në varrezat ekzistuese.

Rezulton se sipërfaqja pranë varrezave ekzistuese është më status privat, është e llojit “arë” e regjistruar në volum 2, faqe 161, zk 2723, konfirmuar nga zyra vendore e Agjensise Shtetërore të Kadastrës Berat. Për këtë pasuri rezulton të jetë bashkëpronar z. Thanas Enver Kristos, për pasurinë e llojit “arë”, me nr. 1189/25 ,me sipërfaqje të përgjithëshme 1804 m², ndodhur në Zonën Kadastrale 2723, me indeks harte K-34-112-190-C, në fshatin Moravë, Bashkia Berat.

Për këto arsye, në mbështetje të ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar si dhe VKM nr. 127 datë 23.03.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar sipas nenit 8 gërma c), bashkëlidhur ju përcjellim dokumentacionin si më poshtë:

- Lista e pronarëve të pasurive private, pasuritë e të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimin

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshur, si dhe informacionit të dërguar nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Berat me shkresën nr. 2608 prot, datë 18.05.2021, lista e pronarëve të pasurisë pronë private që shpronësohet me adresën përkatëse, me cmimet e miratuara jepen si më poshtë:

Nr.	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Pronari që shpronësohet	Sip.e pasurisë m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera	Vlera Totale
1	1189/25	arë	Thanas Enver Kristos	1804	203	366212	366212

Objekte dhe persona të tretë që kompensohen nuk ka.

Fondi për përballimin e kostos financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë.

Faleminderit!


DREJTORI I FINANCES

Rovena SHEHU



DREJTORI DECTP

Erlin KUÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË SHPRONËSIMIT ME QËLLIM ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE NË FSHATIN MORAVË**

Kryetari i Bashkisë mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9, pika 1.2, nenit 54, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”, ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore, VKM nr. 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.712 datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e RSH-së, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 717, datë 24.10.2019, “Për ngritjen e Komisionit për formatimit të dokumentacionit për proçedurat e shpronësimit për interes publik” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të miratojë proçedurën për shpronësim për interes publik për realizimin e projektit për zgjerimin e varrezave publike të Fshatit Moravë, Njësia Administrative Otlak, të pasurive private që preket nga ky projekt:

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	ZK	Konfirmuar ASHK	Sip. që shpronësohet m ²	Vlera Totale
1	Thanas Enver Kristos	1189/25	tokë arë	2723	PO	1804	366212

2. Shpronësimi do të financohet me fondet e Buxhetit të Bashkisë Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

Njoftim

Berat, më 30 / 09 /2021

Ora 11 :00

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Berat në sallën e Këshillit Bashkiak

I nderuar këshilltar!

Ju njoftoj se ditën e enjte më datë 30.09.2021 ,ora 11:00 do të zhvillohet mbledhja e rradhes së Këshillit Bashkiak ,e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të ligjit 139/2015,neni 53 pika 4),me këtë rend dite:

- ✓ **1.Relacion dhe Projektvendim:** “Mbi miratimin e kërkesës së Bashkisë Berat, së bashku me dokumentacionin tekniko- ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Andrea Lamkollari banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri , nga buxheti i bashkise dhe buxheti i vitit 2021 në ministrinë e mbrojtjes , programi “ emergjencat civile “
- ✓ **2.Relacion dhe Projektvendim:** “Për fillimin e procedurave të shpronësimit me qëllim zgjerimin e varrezave publike në Burdullias, Berat”.
- ✓ **3.Relacion dhe Projektvendim:** “Për fillimin e procedurave të shpronësimit me qëllim zgjerimin e varrezave publike në Fshatin Moravë”.
- ✓ **4.Relacion dhe Projektvendim:** “Mbi miratimin e projektit me objekt “P06_ Restaurimi i Peisazhit Historik Urban të sheshit të Selamllëkut-Berat”, “Miratim vendimi mbi shpronësimet për realizimin e projektit P06”

- ✓ **5.Relacion dhe Projektvendim:** “ Për një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 81 datë 29.12.2020 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023 ”.
 - ✓ **6.Material Informues:** “Mbi miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë së Beratit , i përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar, Faza e Rishikuar “.
 - ✓ **7.Të ndryshme**
- Komisioni i Infrastrukturës do të mbledhet ditën e mërkurë ,më datë 29/09/2021,ora 10:00(në bashki)
 - Komisioni i Ekonomisë do të mbledhet ditën e mërkurë ,më datë 29/09/2021,ora 11:00(në bashki)

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ERVIN CECA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 4702 prot.

Berat, më 18.09 2021

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar Zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues për “Për një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 81 datë 29.12.2020 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023 ”.

KRYETARI

Ervin Demo

Konfirmoi :

Drejtoria Juridike : Petro Sinjari

Konceptoi :

Rovena Shehu , Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Datë: / / 2021

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit : 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 3





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 81 DATË
29.12.2020 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2021
DHE PBA 2021-2023 ”**

Këshilli Bashkiak Berat pasi u njoh me materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Berat “Për një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 81 datë 29.12.2020 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023” , mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr 81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2021 dhe PBA 2021-2023”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023” bëhen ndryshimet (pakësime dhe shtesa) në programet buxhetore si më poshtë:

Pakësime

Emërtimi i programit	Kodi i programit	Kap.	Llog.	Kod Projekti	Shuma LEK	Njesia Shpenzuese
Çështje financiare dhe fiskale	01120	05	600	9999999	2,500,000	Bashkia Berat
Projekte zhvillimi	04740	05	600	9999999	2,500,000	Bashkia Berat
Planifikimi urban	06140	05	600	9999999	1,500,000	Bashkia Berat
Totali i pakësimeve					6,500,000	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Shtesa

Emërtimi i programit	Kodi i programit	Kap.	Llog.	Kod Projekti	Shuma LEK	Njesia Shpenzuese
Shërbimet publike vendore	06260	05	600	9999999	100,000	Bashkia Berat
Shërbimet publike vendore	06260	05	601	9999999	50,000	Bashkia Berat
Sport dhe argëtim	08130	05	603	9999999	6,000,000	Bashkia Berat
Strehimi social	10661	05	231	1020177	350,000	Bashkia Berat
Totali i shtesave					6,500,000	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT**

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 81 DATË
29.12.2020 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN
2021 DHE PBA 2021-2023 ”**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, paraqesim propozimin për disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Berat , buxhet i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023” .

Gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit, në përfundim të periudhës 8-mujore, duke analizuar realizimin faktik dhe situatën e pritshme deri në fund të vitit, është vlerësuar e nevojshme një rishpërndarje e fondeve në disa prej programeve buxhetore.

Konkretisht :

1. Të pakësohet me 6,500,000 Lekë artikulli i Shpenzimeve për Paga.

Në disa programe buxhetore janë krijuar fonde të lira të pagave, për arsye të vendeve të paplotësuara në strukturat përkatëse . Po ashtu, në fondin e pagave për 8-mujorin rezultojnë i papërdorur fondet e veçantë, i cili është parashikuar në masën 1 % të fondit vjetor të pagave.

Konkretisht, propozojmë të pakësohet fondet e pagave në programet buxhetore si më poshtë :

1. Çështje Financiare dhe Fiskale (kodi 01120) – të pakësohet fondet e pagave me 2,500,000 Lekë.

Fondet vjetor të planifikuara të pagave në këtë program është 19,554,925 Lekë dhe realizimi si 8-mujor është 10,682,736 Lekë. Numri i punonjësve sipas strukturës është 26 punonjës, numri faktik i punonjësve në 8-mujor është 23.

2. Projekte Zhvillimi (kodi 04740) – të pakësohet fondet e pagave me 2,500,000 Lekë.

Fondet vjetor të planifikuara të pagave në këtë program është 20,212,000 Lekë dhe realizimi si 8-mujor është 11,104,804 Lekë. Numri i punonjësve sipas strukturës është 26 punonjës, numri faktik i punonjësve në 8-mujor është 21.

3. Planifikimi Urban (kodi 06140). – të pakësohet fondet e pagave me 1,500,000 Lekë.

Fondet vjetor të planifikuara të pagave në këtë program është 11,329,000 Lekë dhe realizimi si 8-mujor është 5,705,222 Lekë. Numri i punonjësve sipas strukturës është 15 punonjës, numri faktik i punonjësve në 8-mujor është 11.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Emërtimi i programit	Kodi i programit	nr punonj. ne strukture	nr punonj. faktik	Buxheti v.2021 i pagave	Fakti 8 mujor	Diferenca	Shuma e propozuar për pakësim
Çeshtje financiare dhe fiskale	01120	26	23	19,554,925	10,682,736	8,872,189	2,500,000
Projekte zhvillimi	04740	26	21	20,212,000	11,104,804	9,107,196	2,500,000
Planifikimi urban	06140	15	11	11,329,000	5,705,222	5,623,778	1,500,000

2. Të bëhet shtesa në shumën 6,500,000 Lekë në programet buxhetore si më poshtë :

- Shërbimet publike vendore (kod i 06260) – të shtohet buxheti për artikullin Paga në shumën 100,000 lekë dhe për artikullin Kontributet e sigurimeve në shumën 50,000 Lekë.
- Sport dhe Argëtim (kod i 08130) – të shtohet buxheti në artikullin Subvencion për Futboll FK Tomori 1923 në shumën 6,000,000 Lekë.
Fondi i planifikuar për vitin 2021 është 27,000,000 Lekë, realizimi në periudhën 8-mujore është 22,180,000 Lekë. Fondet e mbetura sipas planit janë të pamjaftueshme për vijimin e kampionatit. Me objektivin për pjesëmarrjen e ekipit në kategorinë superiore është investuar në blerjen e lojtarëve më cilësorë. Po ashtu synohet edhe likuidimi i detyrimeve të prapambetura.
- Strehimi social (kod i 10661) – të shtohet buxheti në artikullin Investime në shumën 350,000 Lekë. Kjo shumë është e nevojshme për likuidimin e investimit Rikonstruksion i banesave të familjeve të varfëra, pjesa e mbetur e faturës për situacionin përfundimtar.

Emërtimi i programit	Kodi i programit	Llog.	Emërtimi i Shpenzimit	Buxheti v. 2021	Fakti 8 mujor	Diferenca	Shuma e propozuar për shtesë
Shërbimet publike vendore	06260	600	Paga	6,462,000	4,291,756	2,170,244	100,000
Shërbimet publike vendore	06260	601	Sigurime	1,069,000	716,723	352,277	50,000
Sport dhe argëtim	08130	603	Subvencion	27,000,000	22,180,000	4,820,000	6,000,000
Strehimi social	10661	231	Investime	2,486,000	2,486,000	0	350,000

Për sa më sipër, kërkojmë të miratohet ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 81 datë 29.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023" si më poshtë :

- Ndryshime në programet përkatëse, në pasqyrën " Detajimi i buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2021 sipas programeve", si më poshtë:

Pakësime

Emërtimi i programit	Kodi i programit	Kap.	Llog.	Kod Projekti	Shuma LEK
Çeshtje financiare dhe fiskale	01120	05	600	9999999	2,500,000
Projekte zhvillimi	04740	05	600	9999999	2,500,000
Planifikimi urban	06140	05	600	9999999	1,500,000
Totali i pakësimeve					6,500,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Shtesa

Emërtimi i programit	Kodi i programit	Kap.	Llog.	Kod Projekti	Shuma LEK
Shërbimet publike vendore	06260	05	600	9999999	100,000
Shërbimet publike vendore	06260	05	601	9999999	50,000
Sport dhe argëtim	08130	05	603	9999999	6,000,000
Strehimi social	10661	05	231	1020177	350,000
Totali i shtesave					6,500,000

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,

DREJTOR I MENAXHIMIT FINANCIAR DHE TË ARDHURAVE

Rovena Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Nr. 4706 prot.

Berat, më 22.09, 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin “Për fillimin e procedurave të shpronësimit me qëllim zgjerimin e varrezave publike në Burdullias, Berat”.

KRYETARI

Ervin DEMO



Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi, Drejtorja e Emergjencave Civile Pronave Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi:

Denada Gjogu, Përgjegjëse e Sektorit të Menazhimit të Mbetjeve

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT ME QËLLIM ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE NË BURDULLIAS, BERAT

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat ka filluar shpronësimin për interes publik për pasurinë nr. 4/149 e llojit "tokë arë", në ZK 8501, me qëllim zgjerimin e varrezave publike në Burdullias, Berat.

Bashkia Berat ka bërë përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e hapësirave të lira të tokës, për krijimin e kushteve të përshtatshme për tu përduror, për banorët e kësaj zone që ndërrojnë jetë. Realizimi i këtij investimi është një domosdoshmëri, për shkak të mungesës së sipërfaqjeve të lira në varrezat ekzistuese, duke shkaktuar problem me menaxhimin e rasteve kur banorë të kësaj zone ndërrojnë jetë.

Kur numri i vdekjeve është rritur në mënyrë të ndjeshme edhe për shkak të pandemisë, kërkesa për zgjerimin e varrezave është sa e nevojshme dhe që kërkon reagim të menjëhershëm, si një rast emergjence pasi janë ezauruar të gjitha mundësitë për shfrytëzimin maksimal të vendeve në varrezat ekzistuese.

Rezulton se sipërfaqja pranë varrezave ekzistuese është më status privat, është e llojit "arë" e regjistruar në volum 18, faqe 6, zk 8501, konfirmuar nga zyra vendore e Agjensise Shtetërore të Kadastrës Berat. Për këtë pasuri rezulton të jenë bashkëpronarë znj.Myrifete Iliaz Peshtani dhe znj.Feride Ibrahim Bego, për pasurinë e llojit "arë", me nr. 4/149, me sipërfaqje të përgjithëshme 2420m², ndodhur në Zonën Kadastrale 8501, me indeks harte BR-D-4, Bashkia Berat.

Për këto arsye, në mbështetje të ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar si dhe VKM nr. 127 datë 23.03.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar sipas nenit 8 gërma c), bashkëlidhur ju përcjellim dokumentacionin si më poshtë:

- Lista e pronarëve të pasurive private, pasuritë e të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshur, si dhe informacionit të dërguar nga zyra vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Berat me shkresën nr. 110/1 prot, datë 12.04.2021, lista e pronarëve të pasurisë pronë private që shpronësohet me adresën përkatëse, me emimet e miratuara jepen si më poshtë:

Nr.	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Pronari që shpronësohet	Sip.e pasurisë m²	Çmimi lekë/m²	Vlera	Vlera Totale
1	4/149	arë	Myrifete Iliaz Peshtani Feride Ibrahim Bego	2420	203	491260	491260

Objekte dhe persona të tretë që kompensohen nuk ka.

Fondi për përballimin e koston financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë.

Faleminderit!

DREJTORI I FINANCES

Rovena SHEHU



DREJTORI DECTP

Erlin KUÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË SHPRONËSIMIT ME QËLLIM ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE NË BURDULLIAS, BERAT**

Kryetari i Bashkisë mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9, pika 1.2, nenit 54, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”, ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore, VKM nr. 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.712 datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e RSH-së, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 717, datë 24.10.2019, “Për ngritjen e Komisionit për formatimit të dokumentacionit për proçedurat e shpronësimit për interes publik” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të miratojë proçedurën për shpronësim për interes publik për realizimin e projektit për zgjerimin e varrezave publike Burdullias, të pasurive private që preket nga ky projekt:

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	ZK	Konfirmuar ASHK	Sip. që shpronësohet m ²	Vlera Totale
1	Myrifete Iliaz Peshtani Feride Ibrahim Bego	4/149	arë	8501	PO	2420	491260

2. Shpronësimi do të financohet me fondet e Buxhetit të Bashkisë Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca